

VENDIM
Nr. 395, datë 20.6.2012

**PËR TRAJTIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT DHE PËRFITIMIN E SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE NGA KJO KATEGORI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Viktimat e trafikimit përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Kontributi në fondin e sigurimeve shëndetësore për viktimat e trafikimit paguhet nga shteti në përputhje me nenin 34 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për pajisjen e viktimave të trafikimit me dokumentin zyrtar sipas formatit të përcaktuar në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, ky vendim shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha